



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË SË QYTETIT KORCË

VENDIM

Nr. 2 ,Datë 14 / 01 / 2011

PËR

**NXJERRJEN JASHTË PËRDORIMIT TË MATERIALEVE TË
INVENTARIT EKONOMIK DHE ATIJ TË IMËT**

Këshilli I Bashkisë së Qytetit Korçë, I mbledhur në datën e sotme, mbasi mori në shqyrtim materialin e pergatitur nga Komisioni I Inventarizimit dhe Drejtoria e Financës për nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve të inventarit ekonomik dhe atij të imët, në zbatim të Ligjit nr.8652,datë 31.07.2000 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32 pika “e”, Ligjin nr.6492, datë 25.12.1984 “Per administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave meteriale dhe monetare”, të ndryshuar me Ligjin nr. 7426,datë 14.11.1990, V.K.M nr.70,datë 11.03.1985 ” Për administrimin,ruajtjen,dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave meteriale dhe monetare”,të ndryshuar me V.K.M Nr.170, date 03.04.1993, si dhe mbas diskutimeve të Këshilltarëve ,

VENDOSI:

1. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit të materialeve sipas llogaritjeve të mëposhtme:
 - a. Inventar ekonomik 386,058 (Treqind e tetedhjet e gjashte mije e pesedhjet e tete) lekë.
 - b. Inventar I imët 131,051 (Njeqind e tridhjet e nje mije e pesedhjet e nje) lekë.
2. Materialet të cilat do të nxirren jashtë përdorimit janë të pasqyruara në procesverbalet bashkangjitur këtij vendimi.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Financës dhe Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll-Arkivit dhe Shërbimeve Mbështetese.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes.

KRYETARI

GJERGJI PENDAVINI

VENDIM

Nr 3 date 14.01.2011

Per prishjen e shoqerise "Korca 2008" Sh.A

Ne baze te Ligjit nr 9901 date 14/04/2008 "Per tregetaret dhe shoqerite tregetare", neni 144, neni 145, neni 187, pika ç ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te Ligjit nr 9723 date 03/05/2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", neni 188 pika 1, si dhe neni 191, pika 2 te po ketij ligji, si dhe neni 6 te Statutit te Shoqerise "Mbi kopetencat e asamblese se pergjithshme", Asambleja e Pergjithshme, pas shqyrtimit te relacionit te paraqitur nga Keshilli Mbikqyres "Korca 2008" sha si dhe pas diskutimeve

VENDOSI:

1. Te miratoje prishjen e shoqerise "Korca 2008"
2. Te ngarkoje administratorin e meparshem te shoqerise "Korca 2008", te regjistroje prane QKR, prishjen e "Korca 2008" Sh.A.
3. Ky vendim hyn ne fuqi menjehere

KRYETAR

Gjergji Pendavinji

